



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 823/6 Prot.

Tiranë, më 05.02. 2016

**V E N D I M**  
**Nr.17, datë 05.02.2016**

*“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,  
filluar me Urdhrin nr. 823/2 prot., datë 14.12.2015”*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Bashkinë Kukës, për rastin e lirimit të padrejtë nga detyra të nëpunëses \*\*\*\*\*,

**VËREJ SE :**

Në zbatim të Urdhrit të verifikimit nr. 823/2 prot., datë 14.12.2015, pasi është shqyrtuar informacioni i marrë nëpërmjet një letre dërguar nga nëpunësja e Bashkisë Kukës, \*\*\*\*\* , protokolluar me nr. 823/1, datë 07.12.2015, është kryer verifikimi i ligjshmërisë në lidhje me respektimin e procedurës në nxjerrjen e aktit administrativ nr. 298, datë 10.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Kukës, për lirimin e saj nga shërbimi civil dhe kalimin në një pozicion jashtë këtij shërbimi.

Nga aktet e administruara rezulton se, punonjësja ka filluar marrëdhënien e punës në Bashkinë Kukës, me aktin e emërimit nr. 320, datë 14.12.2007, në detyrën “Specialiste Personeli” (vërehet se në këtë emërim nuk është respektuar procedura e konkurrimit që parashikohej prej ligjit nr. 8549 dt. 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” që ishte efektiv në atë kohë).

Në vijim, në datën 21.05.2009, po me akt emërimi , ka kaluar në detyrën “Përgjegjëse e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”, pozicion në të cilin e gjeti edhe momenti i fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Duke qenë në rrethanat e punësimit të saj për më tepër se një vit, pa ndërprerje, në pozicionin “Përgjegjëse e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe

*Sporteve*” në bazë të nenit 67 pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil*”, njësia përgjegjëse e Bashkisë Kukës, me aktin nr. 45/1, datë 01.07.2014, me të drejtë ka deklaruar statusin e punësimit të punonjës \*\*\*\*\* si nëpunëse civile në këtë pozicion.

Shkaku i mosmarrëveshjes, që është në thelbin e informacionit të mbërritur tek Komisioneri, lidhet me aktin administrativ nr. 298, datë 10.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Kukës, “*Për lëvizje në detyrë*”, me të cilin është urdhëruar lirimi i nëpunëses në fjalë, nga detyra “*Përgjegjëse e Arsimit, Kulturës, Rinis dhe Sporteve*” dhe kalimi në detyrën “*Punëtore Gjelbërimi*”, me motivacionin, e performancës të dobët në punë.

Akti i mësipërm shoqërohet me një relacion të datës 09.11.2015 “*Për shqyrtimin disiplinor të shkeljeve të kryera nga nëpunësja \*\*\*\*\**”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore, në të cilin parashtrohet se, titullari i Bashkisë Kukës, në datën 10.11.2015, ka filluar procedimin disiplinor ndaj nëpunëses \*\*\*\*\* bazuar në disa shkelje disiplinore kryer prej saj dhe në disa masa disiplinore të mëparshme, të cilat konsistojnë në pjesëmarrje në aktivitete politike, në mosrespektimin e afateve në mënyrë të vazhdueshme dhe mos kryerjen si duhet të detyrave të ngarkuara (sipas këtij relacioni, për moskryerjen në afat dhe me cilësinë e duhur të detyrave, është shprehur edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, në raportin përfundimtar nr. 267/12, datë 25.07.2015), e arsye të tjera që janë evidentuar në këtë rast.

Në përfundim të këtij procedimi disiplinor, për arsyet e përmendura më sipër, rezulton se, Kryetari i Bashkisë Kukës, ka vendosur largimin e nëpunëses \*\*\*\*\* nga pozicioni “*Përgjegjëse e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve*” dhe kalimin e saj në detyrën “*Punëtore Gjelbërimi*”.

Duke analizuar nga pikëpamja ligjore aktin objekt verifikimi, pavarësisht emërimit të tij “*Lëvizje në detyrë*”, në fakt kemi të bëjmë me një procedim disiplinor, i cili ka përfunduar me masën disiplinore “*Lirim nga shërbimi civil*” dhe kalimin në një detyrë jashtë shërbimit civil.

Detyra e mëparshme që kryente kjo nëpunëse, në pozicionin “*Përgjegjëse e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve*”, bën pjesë në shërbimin civil, pasi lidhet me ushtrimin e autoritetit publik dhe me formulimin dhe zbatimin e politikave në atë fushë. Për këtë shkak, kjo punonjëse gëzon statusin e nëpunësit civil, çka passjell detyrimin ligjor nga ana e institucionit për respektimin e gjithë kërkesave dhe procedurave që parashikojnë nenet 57, deri 60, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Vendimi nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*” dhe Udhëzimi nr. 1, datë 02.04.2014 “*Për elementët proceduralë dhe materialë të ecurisë disiplinore dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*”, të Departamentit të Administratës Publike, në rastin e zhvillimit të një ecurie disiplinore.

Duke analizuar aktin objekt hetimi administrativ në këtë kontekst, konstatohet se, në nxjerrjen e aktit nr. 298, datë 10.11.2015, “*Për lëvizje në detyrë*”, të nëpunëses \*\*\*\*\* nuk janë respektuar procedurat e përcaktuara nga aktet ligjore e nënligjore të përmendura më sipër.

Largimi nga shërbimi civil, i cili parashikohet si një nga llojet e masave disiplinore, në pikën “ç”, të nenit 58, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, është nga ato masa që, bazuar në pikën 2, të nenit 59, janë në kompetencë për trajtim nga ana e Komisionit Disiplinor, i cili funksionon në bazë të pikave 4 deri 9, të nenit 59 dhe nenit 60, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë në bazë dhe në zbatim të tyre.

Fillimi i ecurisë disiplinore dhe marrja e vendimit përfundimtar nga ana e Kryetarit të Bashkisë me aktin nr. 298, datë 10.11.2015, “Për lëvizje në detyrë”, është një veprim administrativ i kryer në kapërcim të kompetencave dhe në kundërshtim me procedurën e parashikuar prej ligjit, prandaj në bazë të nenit 116, pikat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, është veprim absolutisht i pavlefshëm dhe si i tillë, në bazë të nenit 117/1, të ligjit të mësipërm, akti nuk mund të prodhojë pasoja ligjore, pavarësisht nga fakti nëse është deklaruar apo jo i pavlefshëm.

Për trajtimin e rastit në përputhje me ligjin në fuqi, nëse do të vlerësohet se ka vend për të mbajtur qëndrim disiplinor ndaj nëpunëses, Kryetari i Bashkisë, me cilësinë e eprorit direkt, në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të fillojë ecurinë disiplinore dhe t’ia kalojë për kompetencë shqyrtimi Komisionit të Disiplinës. Ky mekanizëm duhet të jetë i ngritur pranë institucionit sipas përbërjes së përcaktuar në pikën 3, të nenit 59, të ligjit në fjalë dhe në pikën 3, të Kreut I, dhe Kreun II, të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe duhet të funksionojë sipas rregullave të përcaktuara në nenet 57 dhe 60 të ligjit në fjalë.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 14, 15 dhe 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenet 115, pika “a”, 116 pika “c” dhe 117, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative në R. SH”; nenin 35 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit,

#### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për revokimin e aktit administrativ nr. 298, datë 10.11.2015, “Për lëvizje në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Kukës, për lëvizjen e nëpunëses \*\*\*\*\*, nga detyra “Përgjegjëse e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”, në detyrën “Punëtore Gjellbërimi”, si akt absolutisht i pavlefshëm dhe të rifillojë ecurinë disiplinore, duke ja kaluar për kompetencë Komisionit Disiplinor.
2. Të ngrihet Komisioni Disiplinor i Bashkisë Kukës, sipas përbërjes dhe rregullave të funksionimit, përcaktuar në pikën 3, të nenit 59, të ligjit në fjalë dhe në pikën 3, të Kreut I, dhe Kreun II, të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e

*vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014 “Për elementët proceduralë dhe materialë të ecurisë disiplinore dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, të Departamentit të Administratës Publike.*

3. Komisioni Disiplinor, trajtimin e këtij rasti duhet të fillojë me njoftimin e nëpunëses për shkaqet e ecurisë disiplinore, për datën dhe vendin ku do të zhvillohet seanca e shqyrtimit duke i garantuar asaj, të drejtën që ka për tu dëgjuar, për të paraqitur me shkrim sqarimet e saja, për paraqitjen e provave; të caktojë një punonjës teknik që do të ketë për detyrë mbarëvajtjen e shqyrtimit të çështjes, të kujdeset për mbajtjen e procesverbalit, i cili përmban një përmbledhje të gjithçkaje që trajtohet në seancë, çështjet që u diskutuan, argumentet për vendimmarrje, aspekte të tjera procedurale, e në përfundim, nëse shkeljet e pretenduara provohen, të dalë me vendim, duke përzgjedhur një nga llojet e masave që mund të zbatohen ndaj nëpunësve civil në procedimin disiplinor, sipas rregullit të përcaktuar në nenin 60, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
4. Bashkia Kukës, të zbatojë vendimin brenda 15 ditëve nga data e marrjes dijeni, dhe pas këtij afati të njoftojë Komisionerin, për zbatimin e vendimit.
5. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Kukës dhe kërkuesja \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**